



## 110-VJETORI I PAVARËSISË, SHQIPËRIA SOT KONTRIBUESE E DENJË NË SFIDAT QË PREKIN MBARË BOTËN

MEPJ Olta Xhaçka ka uruar të gjithë shqiptarët brenda dhe jashtë vendit me rastin e 110 vjetorit të Pavarësisë dhe Ditës së Flamurit, ku theksoi se ky është një moment krenarie për gjithë shqiptarët, por edhe një moment për të reflektuar mbi arritjet dhe punën që duhet çuar përpara.



## TAKIMI NDËRQEVERITAR SHQIPËRI-RMV, MIRATOHEN DY MEMORANDUME NË KUADRIN E POLITIKËS SË JASHTME

U mbajt në Shkup, mbledhja e dytë e përbashkët mes qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Maqedonisë së Veriut, ku u nënshkruan në total 21 marrëveshje. MEPJ Olta Xhaçka dhe homologu Bujar Osmani nënshkruan dy memorandume bashkëpunimi: ai për digjitalizimim e shërbimeve konsullore dhe për bashkëpunimin në fushën e trajnimeve diplomatike.



## MINISTERIALI I NATO-S, SHQIPËRIA RIKONFIRMOHET SI NJË FAKTOR KYÇ NË STABILITETIN E RAJONIT

MEPJ Olta Xhaçka, mori pjesë në takimin e Ministrave të Jashtëm të NATO-s që u mbajt në Bukuresht. Në këtë ministerial u diskutua mbi mënyrat për forcimin e qëndrueshmërisë, zhvillimin e aftësive dhe ruajtjen e pavarësisë politike të aleatëve të NATO-s, të cilët janë më të ekspozuar ndaj kërcënimit nga lindja. Gjatë ministerialit, MEPJ Olta Xhaçka, zhvilloi takime edhe me Zëvendëskryeminstri dhe Ministri të Punëve të Jashtme të Italisë, Antonio Tajani, Ministri të Punëve të Jashtme të Gjermanisë, Annalena Baerbock dhe Ministri të Jashtëm të Estonisë, Urmas Reinsalu.



## KOSOVA, PRIORITET ABSOLUT PËR SHQIPËRINË

MEPJ Olta Xhaçka ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Kosovë ku zhvilloi takime me Ministri të Punëve të Jashtme dhe Diasporën të Kosovës, Donika Gërvalla-Schëarz; Presidentin Vjosa Osmani dhe kryeparlamentarin Glauk Konjufca. Ministri Xhaçka përgëzoi qeverinë e Kosovës për arritjen e marrëveshjes me palën serbe për çështjen e targave, teksa theksoi se mbështetja e dialogut Kosovë-Serbi është primare për Shqipërinë, si një domosdoshmëri për gjithë rajonin.



## SHQIPËRI-SHBA NË KËSHILLIN E SIGURIMIT: GRATË PO ÇOJNË PËRPARA PROCESIN E PAQES

MEPJ Olta Xhaçka priti në një takim ambasadorin e SHBA-ve në Kombet e Bashkuara, Linda Thomas-Greenfield. Në aktivitetin "Gratë, Paqja dhe Siguria" që u mbajt pas takimit, ministri Xhaçka theksoi se bashkëpunimi i shkëlqyer Shqipëri-SHBA në Këshillin e Sigurimit, ka dhënë një kontribut vërtet të qenësishëm në thellimin e konsolidimit e mëtejshëm të partneritetit strategjik mes dy vendeve.



## TURQIA PARTNERE KYÇE PËR SHQIPËRINË DHE GJITHË RAJONIN

MEPJ Olta Xhaçka ka zhvilluar një vizitë zyrtare në Ankara me ftesë të homologut të saj, Ministri të Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlüt Çavuşoğlu. Ministri Xhaçka vlerësoi bashkëpunimin e ngushtë mes dy vendeve dhe rolin e Turqisë në rajonin tonë, teksa theksoi se bashkëpunimi rajonal mbetet çelësi për përballimin me sukses të kërcënimeve ndaj sigurisë.



## MBËSHTETJE FRANCEZE PËR PROCESIN E INTEGRIMIT EVROPIAN

MEPJ Olta Xhaçka ka zhvilluar një takim me Sekretaren franceze të Shtetit për Çështjet Evropiane, Laurence Boone. Kryediplotatja shqiptare theksoi se Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol konstruktiv, stabilizues dhe proaktiv në rajon, në mënyrë që të ndihmojë në arritjen e paqes, stabilitetit, sigurisë dhe kohezionit.